



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.714/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevcu dhe Ferki Xhaferi anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e Petrit Bajraktari, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Drenas, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me objekt të çështjes, verifikim i rezultateve, për Zgjedhjet lokale të 17.10.2021. në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.10.2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

**HUDHET** e pa palejuar ankesa Anr.714/2021, të datës 22.10.2021, të paraqitura nga Petrit Bajraktari, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për verifikim të rezultateve në vendvotimet 0321E/01R, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 22.10.2021, ka pranuar ankesën Anr.714/2021, nga Petrit Bajraktari, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Drenas, në të cilat pretendon se në qendrën e votimit nr. 0321E/01R, pas mbylljes së vendvotimit dhe numërimit të rezultateve lista e votave për Kuvend Komunal është futur në kutin e votimit, dhe sipas rregullave ajo kuti më nuk është hapur as nga KKZ, në Drenas.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimet nr. 0321E/01R, për faktin se

shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesave nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, në rast se parregullsia e pretenduar nga ankuesi nuk eliminohet për gjatë administrimit në QNR.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**A nr. 714/2021 më datën 25.10.2021**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

**Kryesuesi i Panelit**  
**Zyhej Haxhiu**

